



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. 45/1 Prot

Kopja Nr. 7
Afati i ruajtjes 27 vjet.
Tiranë më, 27.01.2021

Lënda : Dërgohet informacion.

Zotit Elvin LUKU
QENDRA SHQIPTARE "MediaLook"

Tiranë

Në përgjigje të kërkesës suaj, ku kërkohet informacion mbi proceduwart që ndiqen nga Zyra e Shërbimit ndaj Qytetarëve (ZSHQ), në momentin e denoncimit nga qytetarët për humbje/vjedhje e dokumenteve të identifikimit si dhe të dhëna për numrin e dokumenteve të identifikimit të humbura apo të vjedhura përgjatë viteve të fundit, ju sqarojmë se:

Vetë-deklarimet me karakter administrativ përfshijnë:

- Vetë deklarimin e humbjes të pasaportës biometrike.
- Vetë deklarimin e humbjes të kartës së identitetit, etj.

Për vetë deklarimet me karakter administrativ, ndiqet kjo radhë pune:

- Punonjësi i ZSHQ-së bën identifikimin e personit nëpërmjet përputhshmërisë së letërmjofimit të cilin e fotokopjon duke ia bashkëngjitur praktikës. Në rastet e vetë-deklarimit të humbjes së pasaportës biometrike dhe kartës së identitetit, të dhënat e këtyre dokumenteve duhet të merren nga sistemi TIMS.
 - Kryen verifikimin në sistemin TIMS, për të mësuar statusin nëse është person në kërkim ose jo.
 - Kryen procedurën e pranimit të vetë deklarimit, sipas formularit model.
 - Evidenton në regjistër kërkesën për shërbimin ndaj qytetarëve, sipas rubrikave përkatëse dhe të dhënavë që kërkohen për çdo rubrikë.
 - Plotëson vërtetimin sipas vetë deklarimit të bërë nga qytetari duke pasqyruar elementet si: numrin e protokollit, datën, përshkrimin e vetë-deklarimit, numrin e dokumentit, arsyen, emër mbiemër të punonjësit i cili ka kryer marrjen e vetë deklarimit, nënshkrimin e tij, si dhe vulën e ZSHQ-së;
 - Numri i protokollit që do të marrë vërtetimi do të jetëunik, do të pasqyroj numrin e rendorë të fletës së regjistrat, fraksion numrin rendorë të fletës përkatëse.
 - Vërtetimi pasi plotësohet me të gjithë elementët e mësipërm do të nënshkruhet nga punonjësi për shërbimin ndaj qytetarëve dhe vuoset me vulën e ZSHQ-së, të cilin ia jep në moment qytetarit.

Procedurat e deklarimit me karakter Procedural Penal (Vjedhjet);

Afatet e deklarimit procedural penal, i cili në kompetencë të punonjësit me atributet e oficerit të policisë gjyqësore ndjek dy rrugë:

- Nëse punonjësi me atributet e oficerit të policisë gjyqësore e vlerëson se deklarimi nuk ka elementë të veprës penale, pasi kryen marrjen e tij ia dorëzon kundrejt firmës operatorës së ZSHQ-së, e cila ndjek çdo afat të përcaktuar në këtë procedurë standarde në procedurën e deklarimeve me karakter administrativ.

- Nëse punonjësi me atributet e oficerit të policisë gjyqësore e vlerëson se deklarimi ka elementë të veprës penale, ndjek çdo afat të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale lidhur me kallëzimet e shtetasve.

Praktikat e kryera nga zyra e ZSHQ-së apo oficeri i policisë gjyqësore, më tej i nënshtrohen edhe procedurës për shpalljen në kërkim të dokumenteve të humbura apo të vjedhura.

Në lidhje me numrin e mjeteve të identifikimit të humbura/vjedhura, ju sqarojmë se deri në vitin 2016, këto rubrika nuk kanë qenë të specifikuara por hynin në rubrikën e vjedhjeve të tjera. Për vitet 2017 deri 2020 të dhënat janë në tabelën e mëposhtme:

DEKLARIME, VËRTETIME DHE KARTELA PER HUMBJE:	2020
- <i>të kartave të identitetit</i>	50645
- <i>të pasaportave biometrike</i>	17124

DEKLARIME, VËRTETIME DHE KARTELA PER HUMBJE:	2019
- <i>të kartave të identitetit</i>	64078
- <i>të pasaportave biometrike</i>	23173

DEKLARIME, VËRTETIME DHE KARTELA PER HUMBJE:	2018
- <i>të kartave të identitetit</i>	37282
- <i>të pasaportave biometrike</i>	19822

DEKLARIME, VËRTETIME DHE KARTELA PER HUMBJE:	2017
- <i>të kartave të identitetit</i>	37686
- <i>të pasaportave biometrike</i>	18705

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT

Drejtues Madhor Ardi VELIU

